



# RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS NOVOBËRDË

## PARATË DHE POLITIKA



AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU

LOCAL  
SOLUTION



RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS

# NOVOBËRDË

---

## PARATË DHE POLITIKA



AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU





#### Implementing Persons and Organizations for this report:

**FADIL LLAPASHTICA** – Youth Network Novobërdë/ Novo Brdo

**JELENA KOSTIĆ** – Association of Returned Women – Naš Dom

Financuar nga:



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA





### **Përshkrimi i projektit:**

Ky projekt i mbështetur nga Advancing Kosovo Together – Local Solutions (AKT-LS) përmes USAID, ka për qëllim të rrisë integritetin e qeverive lokale duke shtuar monitorimin nga shoqëria civile në këto komuna. Pjesëmarrësit në këtë projekt janë aftësuar: të kenë qasje në informatat për tenderët publikë në nivel komunash, të identifikojnë lidhjet politike në mes të kompanive apo personave që kanë fituar tenderë por që më herët kanë qenë donator të partive politike, gjithashtu edhe verifikimin e deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë shtetëror. Pjesëmarrësit kishin për detyrë që këto njohuri t'i aplikojnë në komunat e tyre dhe të shkruajnë një raport mbi të gjaturat. Kjo punë reflekton njohuritë dhe metodologjinë e fituar nga trajnimi.

### **Deklaratë mohimi**

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë punë e pjesëmarrësve në këtë projekt. Hulumtimi në këto raporte është vetëm punë e këtyre personave dhe jo e organizatave përfaqësuese. Ato gjithashtu nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve të këtij projekti, United States Agency for International Development (USAID). Këto pikëpamje gjithashtu nuk paraqesin qëndrimet e organizatave implementuese Communication for Social Development dhe Organizatës Çohu!.

### **Publikuar nga**

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!  
Rruga: Rustem statovci Nr.17; Prishtinë, Kosova  
Tel / +381 (0)38 248 506  
[www.cohu.org](http://www.cohu.org)

# PËRMBAJ

**08**

Hyrje

**10**

Shpenzimet  
për  
investime  
kapitale

**12**

Kontratat e  
nënshkruara nga  
komuna e Graçanicës  
përmes procedurave  
të prokurimit publik

**09**

Planifikimi i  
shpenzimeve  
kapitale në  
komunë

# TJA

16

Të gjeturat e  
auditorit  
gjeneral ndër vite

22

Lidhjet e  
biznesit me  
politikën

14

Shpërndarja e  
parasë përmes  
prokurimit publik

22

Financimi i  
subjekteve  
politike

24

Përfundime dhe  
rekomandime





# RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS

# NOVOBËRDË

## HYRJE

Në pjesën fillestare të hulumtimit i cili ka të bëjë me periudhën 2008-2013, mund të vërehet lehtë se Komuna e Novobërdës ka pasur vështirësi sa i përket funksionimit, sidomos kur bëhet fjalë për planifikim të buxhetit për investime kapitale dhe prokurim publik, si dhe për shpenzimin e tij. Kjo mund të konsiderohet normale marrë parasysh se Komuna e Novobërdës është njëra prej komunave rishtazi të formuara në Kosovë (2008).

Në pjesën e dytë të hulumtimit i cili ka të bëjë me periudhën 2013-2014 mund të vërehet se funksionalizmi dhe profesionalizmi i komunës është ngritur në një nivel më të kënaqshëm. Fondet janë shfrytëzuar në mënyrë më efikase dhe ato janë pasuar me rezultate. Komuna e Novobërdës nuk ka listë të zezë ndërmarrjesh të cilave u ndalohet qasja në konkurse për tenderë, të paktën sipas listës të cilën na e kanë siguruar zyrtarët komunalë.

Sa u përket të gjeturave kryesore ndër vite (2008 – 2014), ndër të tjera, ato mund të grupohen si vijon:

- Problemet me raportet financiare, të dhënat e pasakta të cilat janë” përcjellur me dëshmitë jo-adekuate dhe pohimet e pasakta;
- Dallime të mëdha dhe mospërputhjet në raporte të të hyrave të parave të gatshme dhe të pagesave në fillim dhe në fund të viteve;

- Problemet me raportin për realizimin e buxhetit;
- Mos-respektimi i marrëdhënieve kontraktuale nga ndërmarrjet dhe mungesën e shqiptimit të masave sipas ligjit nga ana e Komunës;
- Mos-dizajnimi dhe mos-implementimi i auditimit të brendshëm nga ana e Komunës, sipas kërkesës së legjislacionit në fuqi;
- Mungesa e shpalljeve për dhënien e kontratave në shtypin ditor dhe në ueb-faqe të KRPP-së, siç parashihet me Ligjin për Prokurimin Publik;
- Mos-respektimi i procedurave sa i përket kriterëve për përzgjedhjen e tenderëve “ekonomikisht më të favorshëm”, siç parashihet me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 2007/20, seksioni 50.2;
- Mos-paraqitja e saktë e informacioneve mbi pasurinë” nga ana e Komunës;
- Mungesa e një” procesi sistematik për menaxhimin dhe adresimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm;
- Mungesa e një ”strategjie efektive për të mbledhur borxhin historik e cila ndikon në zvogëlimin e aftësisë së Komunës për të planifikuar financimin e projekteve nga burimet vetjake;
- Nevoja për t’i shtuar kontrollet mbi shpenzimet, veçanërisht në fushën e Subvencioneve dhe transfereve, etj.

Në vazhdim mund të shihni se si Komuna e Novobërdës ka planifikuar dhe realizuar mjetet nga fondet për investime kapitale dhe prokurim publik.


Komuna e Novobërdës për investime kapitale dhe prokurim publik për periudhën 2009-2015 ka ndarë fonde të planifikuara si në vijim:



## Planifikimi i shpenzimeve kapitale në komunë


Gjatë viteve 2009-2015 KK Novobërdë ka planifikuar të realizojë 104 projekte kapitale. Numri më i madh i projekteve të planifikuara ka qenë në vitin 2010 me gjithsej, **30 projekte.**

### PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR INVESTIME KAPITALE



Vlera e planifikuar në buxhetet fillestare për shpenzime kapitale ka qenë **3,102,063 €.**


Edhe për nga mjetet e ndara për investime kapitale viti 2010 është viti kur është planifikuar investimi më i madh për investime kapitale



Sipas të dhënave nga raportet vjetore të komunës dhe nga të dhënat e Auditorit Gjeneral gjatë viteve 2009-2015 për investime kapitale janë investuar **4.286.014 €**.  
Në vitin 2011 është investuar më së shumti me gjithsej **1,265,003 €**.




## SHPENZIMET PËR INVESTIME KAPITALE



Në mes mjeteve fillestare të planifikuara dhe mjeteve që janë shpenzuar në fund të vitit ka pasur diferenca të mëdha.

## Dallimet në mes mjeteve të planifikuara në fillim të vitit dhe mjeteve të shpenzuara në fund vit




# Kontratat e nënshkruara nga Komuna e Graçanicës përmes procedurave të prokurimit publik

Nga të dhënat që ne kemi nxjerrur nga web faqja e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), del të jetë që KK Novobërdë ka nënshkruar 286 kontrata përmes prokurimit publik për periudhën Gusht 2008 – Dhjetor 2015

Numri më i madh i kontratave përmes prokurimit publik ka qenë në vitin 2012 me 62 procedura, ndërsa në vitin e fundit (2015) numri i lëndëve të prokurimit ka qenë 24.

## Kontratat e nënshkruara përmes prokurimit publik



Nga këto kontrata, 119 kanë qenë të llojit “punë”, 89 të llojit “furnizim” dhe 77 të llojit “shërbime”

**2008** Në vitin 2008 Komuna e Novobërdës ka hapur një proces prokurimi në fushën e **Furnizimeve**.

**2009** Në vitin 2009 KK Novobërdë ka hapur 16 procese të prokurimit nga të cilat 13 ishin në fushën e **Punëve**, dhe tri në fushën e **Furnizimeve**.

**2010** Në vitin 2010 KK Novobërdë ka hapur 58 procese të prokurimit nga të cilat 34 ishin në fushën e **Punëve**, 22 në fushën e **Furnizimeve** dhe dy ishin në fushën e **Shërbimeve**.

**2011** Në vitin 2011 KK Novobërdë ka hapur 40 procese të prokurimit nga të cilat 16 ishin në fushën e **Punëve**, 18 në fushën e **Furnizimeve** dhe gjashtë ishin në fushën e **Shërbimeve**.

**2012** Në vitin 2012 KK Novobërdë ka hapur 61 procese të prokurimit nga të cilat 15 ishin në fushën e **Punëve**, 14 në fushën e **Furnizimeve** dhe 32 tenderë ishin në fushën e **Shërbimeve**.

**2013** Në vitin 2013 KK Novobërdë ka hapur 55 procese të prokurimit nga të cilat 22 ishin në fushën e **Punëve**, 18 në fushën e **Furnizimeve** dhe 15 ishin në fushën e **Shërbimeve**.


**2014** Në vitin 2014 KK Novobërdë ka hapur 28 procese të prokurimit nga të cilat 15 ishin në fushën e **Punëve**, tri në fushën e **Furnizimeve** dhe dhjetë ishin në fushën e **Shërbimeve**.

**2015** Në vitin 2015 KK Novobërdë ka hapur 24 procese të prokurimit nga të cilat tri ishin në fushën e **Punëve**, nëntë në fushën e **Furnizimeve** dhe 12 ishin në fushën e **Shërbimeve**.

Gjatë viteve 2008-2015 përmes 286 proceseve të tenderimit KK Novobërdë ka shpenzuar 5,715,016 euro. Vetëm në vitin 2010 u shpenzuan përmes prokurimit publik 1,759,322 euro apo 30.8% e të gjitha mjeteve të shpenzuara gjatë viteve periudhës Gusht 2008 – Dhjetor 2015.

Në vitin 2015 u shpenzuan vetëm 279,237 euro përmes prokurimit publik apo 4.9% e të gjitha mjeteve të shpenzuara gjatë këtyre viteve.

## Vlera e kontratave ndër vite



# Shpërndarja e parasë përmes prokurimit publik

Numri I tenderëve të fituar sipas qyteteve prej nga janë kompanitë

✓ 96

Gjilan

✓ 92

Prishtinë

✓ 96

Novobërdë


✓ 96

Kamenicë

Nga 286 kontratat të nënshkruara kanë përfutur 113 kompani, prej tyre 11 kompani që janë të regjistruara në qytetin e Novobërdës kanë fituar 20 tenderë.

Kompanitë që janë të regjistruara në Gjilan kanë fituar 96 tenderë apo 34%, pastaj kompanitë e regjistruara në Prishtinë 92 tenderë apo 32%, dhe Novobërdë dhe Kamenicë me nga 20 tenderë, apo 7%.


Vlera e tenderëve të fituar sipas qyteteve prej nga janë kompanitë



Nga totali i 286 kontratave, pesë kompani kanë fituar 65 prej tyre apo 22.58 % në vlerë 1,709,986 euro. Kompania “Baza Trans” ka fituar numrin më të madh të tenderëve gjithsej 19 tenderë.

Ndërsa 71 kompani tjera kanë fituar vetëm nga një tender.


## Kompanitë që fituan numrin më të madh të tenderëve



Nga 5,715,016 euro të shpenzuara, pesë kompani përmes 63 tenderëve kanë fituar 2,453,610 euro apo 43% të totalit. Kompania “Company Zuka Commerce”

kanë përfituar 675,938 euro, vlerë shumë më e lartë se mesatarja e përgjithshme që kanë fituar kompanitë që është rreth 50,000 euro.

## Kompanitë që fituan më së shumti nga tenderët





# TË GJETURAT E AUDITORIT GJENERAL NDËR VITE

2008

Në bazë të analizës sonë të raportit të auditorit nga viti 2008 i cili ka përfunduar më 31.12.2008, mund të shohim se auditorët e kanë kryer punën e tyre por kanë pasur edhe probleme për shkak të mungesës së dokumenteve të caktuara. Në këtë rast kanë munguar, raportet financiare me të dhënat e sakta sipas dispozitave ligjore, dhe në vend të tyre ka pasur anekse raportesh me pohime të pasakta dhe pa dëshmi adekuate;

Në vazhden e problemeve me raportet financiare, gjithashtu ka pasur dallime të mëdha në raporte të të hyrave të parave të gatshme dhe të pagesave në fillim dhe në fund të vitit (arsyetimi i tyre ka qenë se Komuna nuk ka arritur të zbatojë procedura efikase të prokurimit publik). Nder të tjera, është vërejtur edhe mungesë kërkesash për iniciimin e prokurimit publik të mallrave dhe shërbimeve si:

- Furnizimi me material teknik për shkolla nga “DPT Adi”
- Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Labjane dhe renovimi i tualeteve në zyrën e komuniteteve lokale në Prekovac nga “NNT Abazi”
- Ndërtimi i shkollës së mesme në Bostan nga “NTP Umetnost Projekat”

Gjithashtu mungon marrja e masave adekuate të Komunës ndaj ndërmarrjeve të cilat nuk përfundojnë punën sipas marrëveshjes kontraktuale. Rasti i tillë është ai me ndërmarrjen “Haksholli” e cila nuk e ka respektuar marrëveshjen pas përfundimit të punës dhe komuna nuk ia ka shqiptuar dënimin sipas ligjit. Këtë kishte bërë me arsyetimin se vonesa e tyre me furnizim të drurit nuk e ka rrezikuar punën e institucionit.

Komuna nuk ka dizajnuar dhe nuk ka implementuar funksionin e auditimit të brendshëm. Kjo është gjithashtu kërkesë e legjislacionit aktual në fuqi.

## REKOMANDIMET:

- I rekomandojmë komunës të mos blejë pa kërkesa gjegjëse të Departamenteve dhe ta zbatojë Ligjin për Prokurim Publik.
- I rekomandojmë komunës, të mos nisë procedura të prokurimit publik para përcaktimit të nevojave dhe mjeteve në dispozicion, siç parasheh Ligji për Prokurim Publik.
- Dënimi duhet t'i ngarkohet kryesit të punëve i cili nuk përmbush kushtet e para para në kontratë.
- I rekomandojmë komunës, se hapjen dhe vlerësimin e ofertës për çmim më të ulët të prokurimit duhet ta bëjë Zyrtaari për Prokurim Publik dhe anëtarët e Komisionit, siç parashihet me Ligjin për Prokurim Publik.
- I rekomandojmë menaxhmentit të Komunës të zbatojë politikat dhe procedurat e listës kontrolluese të dosjeve e cila në mënyrë të qartë përcakton renditjen e dokumentacionit në dosje.
- Rekomandojmë që menaxhmenti i Komunës të krijojë një fletë-listë kontrolluese ku përshkruhen qartë dokumentacionet në dosje.
- I rekomandojmë Kryetarit të Komunës të punësojë një person të kualifikuar për ta kryer funksionin e Auditimit të Brendshëm.

Në bazë të hulumtimit tonë për vitin 2009 i cili përfundon më 31.12.2009 vijmë në përfundim se ashtu si në vitin paraprak mungojnë disa dokumente që i pamundësojnë auditorit të bëjë kontroll të plotë.

Mungojnë:

- Raportet financiare, mospërputhja ndërmjet raportit të të hyrave dhe raportit të pagesave;
- Raporti i pakompletuar i buxhetit;
- Mospërputhje ndërmjet pranimit dhe pagesave me para të gatshme;

Gjatë auditimit janë vërejtur rastet në të cilat nuk janë dorëzuar kërkesat për iniciimin e prokurimit publik dhe të cilat duhet të jenë të nënshkruara nga zyrtari për miratim në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik.

Janë identifikuar rastet e kontratave të investimeve kapitale dhe mallrave e shërbimeve si në vijim:

- Ndërtimi i sistemit të ngrohjes për Shtëpinë e Shëndetit të Komunës së Novobërdës, kryesi i punëve „NNP Prespektiva“;
- Ndërtimi i këndeve për ruajtjen e materialeve të ngrohjes (dru dhe thëngjill), kryesi i punëve „NNSH Mak Building“;
- Furnizimi me materiale për ngrohje: dru dhe thëngjill (Lot I: Dru, Lot II: Thëngjill), furnitori „NTP Metali“;
- Furnizimi me materiale i Drejtorisë për Arsim dhe Shëndetësi, furnitori „NTH Hillari – Vitina“;
- Furnizimi me kompjuterë i drejtorive të Komunës së Novobërdës, furnitori „NTH PBC – Kosova“.

Te raportet e auditorit kemi vërejtur dy raste në të cilat mungojnë shpalljet për dhënien e kontratave në shtypin ditor dhe në ueb-faqe të KRPP-së, siç parashihet me Ligjin për Prokurim Publik. Rastet e identifikuar janë:

- Furnizimi me materiale i Drejtorisë për Arsim dhe Shëndetësi, furnitori NTH Hillari – Vitina;
- Furnizimi me inventar për administratë dhe zyre i institucioneve të Komunës së Novobërdës – NTP Libraria ABC;

Është vërejtur se te projekti i asfaltimit të rrugës në Lak Bunjak nga „NPT Kastrioti“ dhe në projektin e mirëmbajtjes së kamionëve të zjarrfikësve nga „NTP Miri“ në procesverbale për hapje të ofertave mungon nënshkrimi i një anëtarë të komisionit, derisa te projekti i furnizimit me kompjuterë i drejtorive të Komunës së Novobërdës nga „NTP PBC – Kosova“ procesverbali i vlerësimit të ofertave nuk është nënshkruar nga dy anëtarë të komisionit.

Gjithashtu është hasur në raste kur komuna nuk i ka respektuar procedurat sa i përket kriterëve për përzgjedhjen e tenderëve “ekonomikisht më të favorshëm” siç parashihet me Ligjin për Prokurim Publik.

Rastet e identifikuar janë:

- Furnizimi me kompjuterë i drejtorive komunale. Furnitori “NTP PBC - Kosova”
- Asfaltimi i rrugës Lak Bunjak. Kryesi i punëve “NTP Kastrioti”.

Gjithashtu mungojnë raportet e mbikëqyrjes së punëve si dhe lista kontrolluese e dosjeve të prokurimit. Përveç kësaj, është shumë me rëndësi të theksohet se Komuna për asnjë ndërmarrje nuk ka zbatuar dënim për shkak të vonësive në kryerjen e punëve apo në furnizim me materiale ose pajisje.

## REKOMANDIMET

- I rekomandojmë menaxhmentit të Komunës që gjatë përgatitjes së raporteve financiare të shfrytëzojë burime të besueshme të informacioneve dhe shënimet e raportit të jenë në përputhje me raportet;
- I rekomandojmë menaxhmentit të Komunës të bëjë përputhje të rregullt ndërmjet Free Balance-it dhe drejtorive dhe ta rrisin besueshmërinë e informacioneve të paraqitura në raporte;
- I rekomandojmë Komunës t'i respektojë të gjitha dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, dhe që të gjitha iniciimet dhe miratimet e prokurimit të bëhen nga ana e zyrtarit për miratim;
- I rekomandojmë Komunës t'i respektojë të gjitha dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik dhe të sigurohet që i gjithë dokumentacioni lidhur me komisionin për vlerësime të jetë i pranishëm nga fillimi e deri në përfundim të procesit;
- I rekomandojmë Komunës të zbatojë dënime ndaj kryesve të cilët nuk i përmbushin afatet dhe kushtet sipas kontratave;
- I rekomandojmë Komunës që deklaratat nën betim të anëtarëve të komisionit vlerësues duhet të jenë të nënshkruara në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik.
- I rekomandojmë Komunës që për përzgjedhjen e tenderëve më të favorshëm ekonomikisht t'i respektojë procedurat e nën-kritereve sipas Ligjit për Prokurim Publik.
- I rekomandojmë Komunës të sigurohet që për çdo projekt të ekzistojë mbikëqyrje e duhur dhe që raportet të ruhen në dosjet e prokurimit.

### 2010

Në bazë të hulumtimit tonë për vitin 2010, vijmë në përfundim se, sikur edhe në vitin paraprak, ka parregullsi të theksuara sidomos te:

- Raporti mbi pranimin dhe pagesën me para të gatshme;
- Raporti mbi realizimin e buxhetit.

Bazuar në hulumtim, në këto raporte nuk përputhen të dhënat sipas numrit të pranimeve dhe pagesave, si dhe vjen deri te mospërputhjet e mëdha të shumave të përmendura. Gjithashtu kjo krijon dyshime se ku mund të jenë drejtuar, pra shpenzuar ato para. Ky raport nuk përmend fare kontrata për tenderë apo investime kapitale.

Rekomandimi- I rekomandojmë menaxhmentit të komunës që gjatë përgatitjes së raportit financiar të përdorë burime të besueshme të informacioneve dhe që shënimet e raportit të jenë në përputhje me raportet.

### 2011

Në bazë të hulumtimit tonë për vitin 2011, shihet se Komuna e Novobërdës nuk i ka paraqitur saktë dhe plotësisht informacionet mbi pasurinë. Në këtë raport gjithashtu nuk i është kushtuar vëmendje e theksuar tenderëve dhe investimeve kapitale. Sa i përket buxhetit, mund të nxirren përfundimet në vijim:

- Buxheti i miratuar për investime kapitale ka qenë 1,314,307€ ndërsa janë shpenzuar 1,265,003€ apo 96%.
- Janë testuar 17 mostra në vlerë prej 365,844 € apo 29% të shpenzimeve totale dhe nuk janë vërejtur parregullsi. Këshilla e cila i është dhënë komisionit gjatë fazës së parë të auditimit që të emërojnë një organ mbikëqyrës para fillimit të punës dhe që të gjitha punët e filluara të kryhen dhe pranohen nga komisioni sipas dokumentacionit të projektit, është adresuar.

## REKOMANDIMET

- I rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë emërimin e një zyrtari për pasuri; formimin e komisionit për regjistrim dhe vlerësim të pasurisë; dhe krijimin një regjistri për pasuritë e komunës në pajtim me UA nr. 21/2009 për menaxhimin e pasurisë qeveritare;
- I rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë një trajtim më serioz në adresimin e rekomandimeve të NjAB, si dhe themelimin e Komitetit të Auditimit me qëllim të fuqizimit të punës së NjAB, adresimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm, dhe rritjes së kontrolleve në komunë.
- I rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë nxjerrjen e politikave të domosdoshme, udhëzimeve dhe procedurave të qarta për të gjitha aktivitetet e rëndësishme siç janë: planifikimi i buxhetit, prokurimi, menaxhimi i shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve dhe pasurisë si dhe raportimi i tyre me kohë.

### 2012

Në bazë të hulumtimit tonë për vitin 2012, në raportin e auditorit për këtë vit nuk janë paraqitur mangësi sa i përket dokumentacionit. Por gjithsesi është vërejtur se rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë marrë parasysh. Mund të shihet se ekziston dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij përfundimtar prej 346,933 €. Kjo diferencë e buxhetit është rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti 2011 në vlerë prej 65,770 €, të hyrave të realizuara përtej planit për 64,596€, grantit qeveritar nga zyra e kryeministrit për ndihmë komunave në vlerë prej 150,001€ dhe donacioneve të jashtme në vlerë prej 66,566€.

Komuna nuk ka një regjistrer adekuat dhe përfundimtar të pasurisë, që e vështirëson përcjelljen dhe lë hapësirë për keqpërdorimin e mjeteve.

Një prej përfundimeve është se te investimet kapitale dhe mallrat dhe shërbimet duhet të rritet kontrolli i prokurimit

(respektimi i kriterëve të dosjeve të tenderit në procesin e vlerësimit të tenderit), të mos nënshkruhen kontratat pa sigurimin e fondeve të mjaftueshme, si dhe të kryhen pagesat nga viti 2011.

## TE GJETURAT:

Te lënda „Ndërtimi i stacioneve të pritjes së autobusëve“ në vlerë prej 37,257€, komuna nuk i kishte bërë pagesat për shkak të mungesës së zotimeve. Të gjitha pagesat është dashur të kryhen në fund të vitit 2011, ndërsa deri me tani është paguar shuma prej 24,384€, ndërsa borxhi i mbetur është 12,873€.

Te kontrata për “Furnizime me material administrativ” e lidhur më 24.07.2012 me vlerë prej 10,556 €, kemi vërejtur se zotimi i mjeteve është bërë me datën 19.11.2012 në vlerë prej 907€, po ashtu raportin e pranimit të mallit nuk e kishte nënshkruar njëri nga tre anëtarët sa ishin të emëruar.

Te lënda „asfaltimi i rrugës në fshatin Jasenovik” në vlerë 110,433 € organi mbikëqyrës i punëve ka dorëzuar raportin për situacionin përfundimtar për pagesë me 14.08.2012 në vlerë prej 29,833 €, mirëpo ishte paguar vetëm 19,400 €. Kjo ishte si pasojë e hyrjes në kontrata pa sigurimin e fondeve.

**Mosekzekutimi i pagesave për punët e përfunduara në realizimin e projekteve kapitale është manifestuar me planifikim të dobët të buxhetit dhe hyrje në obligime pa mbulesë ndaj OE. Ky është tregues se komuna nuk ka nën kontroll aktivitetet e prokurimit dhe harmonizimin e tyre me fondet buxhetore.**

## REKOMANDIMI:

- Kryetari i Komunës duhet të forcojë kontrollet e prokurimit, kontrollet buxhetore dhe ato financiare në mënyrë që të kompletojnë kontratat, si në aspektin e sigurimit të punëve/shërbimeve, ashtu edhe në aspektin e pagesave.

Në bazë të hulumtimit tonë për vitin 2013, në raportin e auditorit për këtë vit është vërejtur

- Prezantim jo i plotë i pasurive që pasqyron dobësi në kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për të konfirmuar plotësinë dhe regjistrimin e saktë të pasurive në pronësi të komunës në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës;
- Mungesa e një procesi sistematik për menaxhimin dhe adresimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm;
- Shpenzimet e larta dhe numri i pagesave të shumta gjatë muajit dhjetor bartin rrezikun që këto pagesa t’iu shmangen kontrolleve të mjaftueshme dhe të njëjtat të bëhen edhe për punët e papërfunduara;
- Mungesa e aktiviteteve për identifikimin e pronave të reja do të rrisë rrezikun që këto prona të mos i nënshtrohen pagesës së tatimit. Mungesa e një strategjie efektive për të mbledhur borxhin historik do të zvogëlojë aftësinë e Komunës për të planifikuar financimin e projekteve nga burimet vetjake;
- Nevoja për t’i shtuar kontrollet mbi shpenzimet, veçanërisht në fushën e Subvencioneve dhe Transfereve; dhe
- Funksioni i Njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk ishte përkrahur mjaftueshëm nga menaxhmenti dhe nga komiteti i auditimit. Vetëm një numër i vogël i rekomandimeve të auditimit të brendshëm ishte zbatuar nga ana e menaxhmentit.

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar është më i lartë për 137,381€. Ky ndryshim ka ndodhur për shkak të të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar në shumë prej 70,285€, të hyrave nga participimi i qytetareve në shumë prej 11,331€, rritje në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve prej 2,040€ si dhe të hyrave nga donacionet e jashtme në shumë prej 53,725€.

Buxheti final për Investime Kapitale ishte ekzekutuar në shkallën 92%, por vetëm në muajin dhjetor ishte shpenzuar 330,345€ apo 49% nga totali;

Janë testuar 18 mostra të pagesave për investime kapitale në shumë prej 389,674€ apo rreth 63% nga vlera e kontratave si dhe 16 pagesa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 72,231€ apo rreth 22%. Përveç rasteve të identifikuara në vijim, procedurat e prokurimit ishin në harmoni me Ligjin mbi Prokurimin Publik (LPP).

## TE GJETURAT:

Në projektin “Furnizim me makina bujqësore” ishte lidhur kontratë në shumë prej 65,085€. Komuna në dosjen e tenderit kishte kërkuar furnizim me 89 pajisje bujqësore përderisa kontratën e kishte lidhur me operatorin për 108 pajisje bujqësore. Ofertuesit kishin konkurrar për 89 pajisje bujqësore. Ky veprim e ka dëmtuar konkurrencën dhe e ka bërë procesin e prokurimit jo transparent.

Me rastin e vlerësimit të menaxhimit të kontratave, ne testuam pagesën në shumë prej 81,920€ të datës 31.12.2013. Pagesa ishte kryer përderisa ne nuk kemi gjetur të bashkangjitur situacionin me përshkrim të punimeve të kryera.

Me rastin e testimit të pagesës në shumë prej 13,000€, të datës 27.12.2013 në emër të furnizimit me inventar për shkollë, nuk kemi gjetur raport me shkrim për pranimin e inventarit nga ana e shkollave.

**Kontrollet e menaxhmentit në proceset e prokurimit janë jo efektive dhe si rezultat i kësaj shfaqet rreziku që me prokurimet e zhvilluara organizata nuk ka arritur të pranojë vlerën për paratë e shpenzuara. Si rezultat i mangësive të theksuara, kanë ndodhë disa pagesa të parregullta dhe prokurime jo transparente.**

## REKOMANDIMI:

- Kryetari i komunës duhet të bëjë rishqyrtimin e rasteve të mësipërme në të cilat proceset nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Po ashtu, duhet të sigurojë se për mangësitë e prezantuara më lartë, do të merren masa konkrete në eliminimin e tyre dhe do të mbajë përgjegjësi zyrtarët të japin llogari siç duhet.

2014

Sa i përket vitit 2014, kësaj here Raporti i Auditorit nuk përmban mangësitë sikurse në vitet paraprake.

Buxheti përfundimtar është për 305,551 € më i lartë se ai fillestar. Bazuar në Raportin e Auditorit, ndër të tjera, kjo është rezultati i shkaqeve si në vijim:

- Rritjes së grantit qeveritar në vlerë prej 277,706 €;
- Bartjes së mjeteve vetanake nga viti paraprak në vlerë prej 26,625 €; dhe
- Donacionet e brendshme në vlerë prej 1,209 €.

Në vitin 2014 komuna ka përdorur 2,114,079€ ose 89% të buxhetit final duke shënuar rënie nga 95% në 2013. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Pavarësisht rritjes në buxhetin për shpenzime kapitale, vetëm 71% e buxhetit final ishte shpenzuar. Fondet e pashpenzuara në shumë 114,432€ ishte si pasojë e mungesës së projekteve dhe menaxhimit të dobët të projekteve ekzistuese;

Raporti i Auditimit, ka përfshirë të gjeturat, rrezikun, rekomandimet dhe konkluzionin për vitin 2014. Të gjitha janë paraqitur si më poshtë:

## TE GJETURAT:

Nga shqyrtimi i kontratave dhe pagesave ne kemi identifikuar një sërë dobësish të përbashkëta, me ndikim mbi disa kontrata të rishikuara. Në veçanti, kontrollet menaxheriale nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive për të parandaluar çështjet e mëposhtme:

- Komuna kishte zhvilluar 20 procedura të prokurimit për aktivitete që nuk ishin të planifikuara. Pesë (5) prej tyre ishin kontrata me procedurë të hapur (në vlerë totale 207,407€). 15 prej tyre ishin kontrata me vlera të vogla për përmbushjen e nevojave momentale të paparashikuara;

- Me vendime të Kryetarit, komuna ka bërë pagesa të parregullta mbi 14,000€ për furnizime dhe shërbime pa pasur kontratë me furnitorët, si në vijim:

- Për material shpenzues në vlerë 1,580 €;
- Fatura në vlerë 9,070€ për servisim të automjeteve. Madje çertifikimi i pagesave, përveç mungesës së kontratës, ishte bërë në mënyrë të parregullt pa zotim të mjeteve, pa kërkesë për blerje, dhe pa urdhërblerja;
- Rregullimi i pompave të ujit në vlerë prej 1,365 €;
- Pagesa në shumë 1,398 € për transport të nxënësve nga fshatrat e komunës;

**Komuna ka dështuar të zbatojë kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregullës Financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike. Dobësitë e theksuara kanë rezultuar me pagesa të parregullta dhe mund të jenë bazë për modifikim të opinionit. Ekziston rreziku i mëtejme se është arritur vlerë e dobët për parane dhe shpenzuar pa kontrata dhe të njëjtat mund të jenë edhe subjekt i mashtrimit.**

## REKOMANDIMI:

- Kryetari duhet të iniciojë një rishikim se pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në këto raste dhe të implementohen kontrollet të shtuara, për të siguruar se situata të tilla nuk mund të përsëriten. Praktikave të pagesave në kundërshtim me ligjin e prokurimit duhet menjëherë të ndërpriten.

Megjithatë komuna e ka zhvilluar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak, asnjë prej atyre rekomandimeve nuk është adresuar plotësisht.

## FINANCIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE

Raportet e auditura të pasqyrave financiare janë të publikuara vetëm për vitet 2009-2012. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk i ka publikuar asnjëherë pasqyrat financiare të subjekteve politike për vitet para vitit 2009, pasi ato janë audituar nga OSBE.

Ndërsa pasqyrat financiar të SP politike pas vitit 2013 nuk janë të audituara sepse Kuvendi i Kosovës ka dështuar të përzgjedhë kompaninë për auditim.

Deri në vitin 2013 në qeverisje të KK Novobërdë ka qenë Lidhja Demokratike e Kosovës.

Pas viti 2013 me KK Novobërdë qeverisë subjekti politik Lista Serbe.

LDK gjatë viteve 2009-2012 ka raportuar 99,685 euro të hyra nga donacione, prej tyre 76,811 euro nga persona fizikë dhe 22,874 euro nga persona juridikë.

Në vitin 2009 auditori ka gjetur që LDK ka shitur patundshmëri në vlerë 380,000.00 euro duke shkelur rregulloren 01/2008 Neni 17 Financimi i partive politike, paragrafi 17.4 sipas te cilit "Partia e regjistruar politike nuk mund të hyjë në asnjë lloj veprimtarie financiare apo fitimprurëse, përpos shitjes së të mirave siç janë publikimet ose posterët me emblemën apo akronimin e partisë në shumë të përgjithshme jo më të madhe se dy mijë (2,000.00) euro në vit.

LDK në vitin 2010 për shkak të tejkalimit të limit ditor për pranim të donacioneve është obliguar që të kthejë tek donatorët 2,856.95 euro

## LIDHJET E BIZNESIT ME POLITIKËN

Nga kontratat e shikuara dhe krahasimi i të dhënave me raportet e pasqyrave financiare të subjekteve politike kemi gjetur që pesë kompani kanë financuar subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës, subjekt i cili qeverisë në nivel qendror. Një nga këto kompani është edhe financuese e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.


Një kompani ka qenë financuese e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, dhe njëkohësisht në pronësi të ish-deputetit të LDK-së, Hashim Dëshishku.

Një kompani ka qenë financuese e subjektit politik Aleanca Kosova e Re, dhe njëkohësisht në pronësi të kryetarit të këtij subjekti, Behgjet Pacolli.

PDK ka pranuar donacion në vlerë 34,100 euro nga këto pesë kompani, ndërsa LVV nga njëra prej kompanive që është edhe financuese e PDK-së ka pranuar donacion 100 euro.

LDK ka pranuar 4,000 euro, ndërsa AKR 5,915 euro nga kompanitë përfituese të tenderëve në KK Novobërdë.


## Vlera e donacionit të pranuar



Këto shtatë kompani kanë fituar nga KK Novobërdë 721,441 euro përmes 23 tenderëve.

Vlerën më të madhe të tenderëve e kanë fituar kompanitë që kanë qenë financuese të PDK-së. Këto kompani kanë fituar 698,947 euro përmes 19 tenderëve

## Vlera e tenderëve të fituar nga kompanitë që kanë financuar SP





# PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në hulumtimin tonë, Komuna e Novobërdës del të ketë probleme të shumta në operimet dhe raportimet buxhetore. Raporti i Auditorit, i cili edhe është analizuar në përpikëri, ka nxjerrë në pah probleme të shumta të cilat ndikojnë në operimin funksional buxhetor.

Në periudhën 2008 – 2014, janë identifikuar probleme duke filluar me planifikimet jo të duhura buxhetore dhe mos-respektimin e dispozitave ligjore të prokurimit publik. Në kuadër të kësaj, janë identifikuar mungesa të shpalljeve për dhënien e kontratave në shtypin ditor dhe në ueb-faqe të KRPP-së, siç parashihet me Ligjin për Prokurimin Publik si dhe mos-respektimi i procedurave sa i përket kritereve për përzgjedhjen e tenderëve “ekonomikisht më të favorshëm”. Andaj, organet përgjegjëse, duhet marrur masat që shkelësit e ligjit të japin përgjegjësi për shkeljen e dispozitave të ligjit për prokurimin publik dhe gjithashtu shpalljet duhet bërë sipas dispozitave të prokurimit publik dhe duhet marrë parasysh neni 50.2 i ligjit i cili ka të bëjë me përzgjedhjen e tenderëve “ekonomikisht më të favorshëm”.

Të dhënat e pasakta financiare, të cilat ishin përcjellë më dëshmitë jo-adekuate dhe dallimet e mëdha dhe mos-përputhjet në raporte të të hyrave të parave të gatshme dhe të pagesave në fillim dhe në fund të viteve ishin të gjeturat tjera në vazhden e identifikimeve në raportin e auditimit.

Raporti i auditorit kishte rekomanduar që të mos fillojë procedura të prokurimit publik para përcaktimit të nevojave dhe mjeteve në dispozicion, siç parasheh Ligji për Prokurim Publik, gjithashtu kishte rekomanduar angazhimin e një auditori të brendshëm që do të ndihmonte në evitimin e problemeve profesionale financiare, mirëpo një gjë e tillë nuk ishte marrë parasysh.

Mungesa e përgjegjësisë dhe ndërmarrjes së masave adekuate ishte vërejtur gjithashtu në marrëdhëniet kontraktuale në mes Komunës dhe Operatorëve (ndërmarrjeve) të caktuara. Edhe pse nuk ishin përfunduar punët sipas marrëdhënies kontraktuale nga ana e ndërmarrjes,

Komuna nuk kishte ndërmarr masat e caktuara ndaj ndërmarrjes së tillë për mos-realizimin e përgjegjësisë që rrjedhin nga marrëdhëniet kontraktuale. Në kuadër të kësaj, konsiderojmë se mos-realizimi i përgjegjësisë që rrjedhin nga marrëdhëniet kontraktuale, është shkelje e marrëdhënies dhe si e tillë, duhet ndëshkuar me masat ligjore.

Të gjeturat e auditimit ndër tjera kishin identifikuar edhe një varg shkeljesh të tjera si: mos-paraqitja e saktë e informacioneve mbi pasurinë nga ana e Komunës, mungesa e një procesi sistematik për menaxhimin dhe adresimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm; mungesa e një strategjie efektive për të mbledhur borxhin historik e cila ndikon në zvogëlimin e aftësisë së Komunës për të planifikuar financimin e projekteve nga burimet vetjake si dhe nevoja për t'i shtuar kontrollet mbi shpenzimet, veçanërisht në fushën e subvencioneve dhe transfereve.

Marrë parasysh rekomandimet ndër vite, konsiderojmë se është i nevojshëm adresimi i rekomandimeve të bëra nga auditori i jashtëm përmes një procesi sistematik. E gjithë kjo, do ndihmonte në adresimin e problemeve të shumta ndër vite e cila gjithashtu, do të ndikonte në evitimin dhe mos-përsëritjen e problemeve të tilla në vitet pasuese.



